

**URDHËR**  
**Nr. 531, datë 28.9.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 351, DATË 29.5.2020 “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga Covid-2019; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si edhe të vendimit të Komitetit Teknik nr. 4286, datë 23.9.2020,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19” të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, germa “c” e urdhrit shfuqizohet.
2. Aktiviteti i pishinave të ofrohet në përputhje me protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 1.10.2020.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË**  
**DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**